



E DREJTA PËR GJYKIM BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Përmbledhje tematike e
praktikës gjyqësore të
Gjykatës Kushtetuese



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Përmbledhje tematike e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

E DREJTA PËR GJYKIM BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM

Kjo përmbledhje tematike është hartuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat autoriale i përkasin Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Përmbledhja tematike do të përditësohet në baza të rregullta nga Gjykata Kushtetuese dhe mund t'i nënshtrohet ndryshimeve redaksionale.

© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2024.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	4
I. E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Parimet e përgjithshme.....	5
A. Përlllogaritja e periudhës	6
B. Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës	6
(i) Ndërlikueshmëria e rastit.....	6
(ii) Sjellja e palëve në procedurë	7
(iii) Sjellja e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike	7
(iv) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin	8
II. Rastet e Gjykatës, përmes të cilave janë vendosur parimet dhe kriteret përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm	9
Lista e rasteve	17

Parathënie

Kjo Përmbledhje Tematike e publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) ka për qëllim të informojë komunitetin juridik, në veçanti përfaqësuesit e palëve dhe vetë palët në lidhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, përmes të cilës janë zhvilluar dhe vendosur parimet dhe kriteret që ndërlidhen me shqyrtimin e kërkesave, përmes të cilave pretendohet cenimi i të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, ashtu siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Përmbledhja Tematike e rasteve të Gjykatës i referohet vetëm atyre aspekteve, për të cilat Gjykata ka arritur të zhvillojë praktikë gjyqësore, përmes të cilës janë aplikuar parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ). Përderisa në lidhje me aspektet tjera, të pambuluara nga praktika gjyqësore e Gjykatës deri më tani, praktikuesit ligjorë dhe lexuesit mund t'i referohen vetë vendimeve të GJEDNJ-së dhe udhëzuesve dhe dokumenteve përkatëse të publikuara në uebfaqen e saj.

Përmes shtjellimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës që ndërlidhet me vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave para gjykatave të rregullta, kjo Përmbledhje Tematike, mes tjerash në mënyrë të përmbledhur do të elaborojë praktikën gjyqësore të Gjykatës, duke specifikuar rastet më relevante në të cilat Gjykata ka zhvilluar parimet dhe kriteret e përgjithshme të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, në të cilat raste, marrë parasysh veçoritë e secilit rast veç e veç, ka aplikuar këto kritere për të vendosur nëse kohëzgjatja e procedurave para gjykatave të rregullta është zhvilluar në pajtim me të drejtën për gjykim brenda nja afati të arsyeshëm.

Më specifikisht, në tri pjesë përmbajtëse, kjo Përmbledhje Tematike në pjesën e saj të parë përvijon dhe shtjellon parimet e përgjithshme dhe më thelbësore përkitazi me të drejtën për gjykim brenda nja afati të arsyeshëm, dhe përfshin shembuj konkret se në cilat raste mund të cenohet kjo e drejtë, duke renditur rastet për secilën situatë në të cilën praktika gjyqësore e Gjykatës tashmë është e zhvilluar dhe mbi të cilat janë konsoliduar këto parime. Përderisa në pjesën e dytë do të pasqyrohen përmbledhjet e disa vendimeve konkrete, në të cilat Gjykata, duke aplikuar parimet dhe kriteret e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore, ka vlerësuar dhe shqyrtuar nëse në rrethanat e rasteve para saj është cenuar e drejta e parashtruesve për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për të përfunduar me pjesën ku është përfshirë lista e vendimeve më relevante të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës.

Duhet theksuar, megjithatë, se ky dokument është i natyrës informuese dhe se shtjellimet dhe çfarëdo reference e përdorur në të duhet të kuptohen dhe interpretohen në kontekstin e rrethanave faktike dhe juridike të rastit përkatës të vendosur. Prandaj, duke qenë se secili rast ngërthen aspekte thujtë unike faktike e juridike dhe vlerësimi i pranueshmërisë së nënshtrohet shqyrtimit të veçantë rast pas rasti nga Gjykata, referenca në këtë Përmbledhje Tematike nuk nënkupton detyrimisht rezultatin e caktuar para Gjykatës.

Për më tepër, duhet të sqarohet se përmbajtja e këtij dokumenti dhe referencat në rastet e Gjykatës nuk janë shteruese. Marrë parasysh natyrën dinamike dhe zhvillimin e vazhdueshëm të praktikës gjyqësore, kjo Përmbledhje Tematike lidhur me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, do t'i nënshtrohet përditësimit të vazhdueshëm. Të gjitha vendimet e referuara në këtë Përmbledhje Tematike janë të publikuara në uebfaqen e Gjykatës dhe janë të qasshme në gjuhën shqipe dhe atë serbe, si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, si dhe në raste të caktuara edhe në gjuhën angleze.

I. E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Parimet e përgjithshme

Neni 31 (2) i Kushtetutës

“[...] 2. 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

Neni 6 (1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

“1. Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”

Gjykata, duke afirmuar konstatimet dhe parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që burojnë edhe nga detyrimi i saj i përcaktuar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore në lidhje me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, e cila, ndër të tjera, përfshin rastet (i) [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) [Poiss kundër Austrisë](#), nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) [Abdoella kundër Holandës](#), nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) [Comingersoll S.A. kundër Portugalisë](#), nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) [Mikulić kundër Kroacisë](#), nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) [Scordino kundër Italisë](#) (nr.1), [DhM] nr.36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) [Frydlender kundër Francës](#), nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) [Sürmeli kundër Gjermanisë](#), nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) [Mishqjoni kundër Shqipërisë](#), nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) [Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë](#), nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019. Thënë këtë, rastet e Gjykatës përmes të cilave ajo ka afirmuar parimet e vendosura nga GJEDNJ dhe të njëjtat i ka aplikuar edhe në rastet për shqyrtim para saj, përfshijnë por nuk kufizohen në rastet (i) [KI 64/23](#), parashtrues *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) [KI 06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlovic*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) [KI 19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) [KI117/19](#), parashtrues *NNT “Sokoli”*, Aktgjykim i 29 marsit 2021; (v) [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2022; dhe (vi) [KI19/17](#), parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 shkurtit 2018.

Në kuptim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në vazhdimësi ka theksuar se është detyrim i shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në atë mënyrë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilës palë për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm.

Në rastet para saj, Gjykata, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për tejzgjatje të procedurave gjyqësore i shqyrton dhe i vlerëson sipas rrethanave të secilit rast **veç e veç**.

- [KI 64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, paragrafi 71; dhe
- [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, paragrafi 109.

A. Përlllogaritja e periudhës

Përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje, me kërkesë të palëve, për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar. Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit.

- [KI19/17](#), parashtrues *Fatos Dervishaj*, paragrafi 50;
- [KI177/19](#), parashtrues *NNT “Sokoli”*, paragrafi 98; dhe
- [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, paragrafi 74.

B. Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës

Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, të cilat i referohen: (a) ndërlíkueshmërisë së rastit; (b) sjelljes së palëve në procedurë; (c) sjelljes së gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest.

- [KI23/16](#), parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, paragrafi 58;
- [KI18/18](#), parashtrues *Isuf Musliu*, paragrafi 43;
- [KI13/19](#), parashtrues *Fevzi Hajdari*, paragrafët 65-72;
- [KI177/19](#), parashtrues *NNT “Sokoli”*, cituar më lart, paragrafët 96-106;
- [KI104/20](#), parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 46;
- [KI135/20](#), parashtruese *Hava Behxheti*, paragrafët 39-54;
- [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, paragrafi 85;
- [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, paragrafi 85;
- [KI06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajloviq*, paragrafi 54; dhe
- [KI03/22](#), parashtrues *EPS “Trgovina”*, paragrafi 54.

(i) Ndërlíkueshmëria e rastit

Ndërlíkueshmëria e rastit mund të ndërlídhjet me çështje të faktit dhe të ligjit por gjithashtu mund të ndërlídhjet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta.

- [KI18/18](#), parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 majit 2018, paragrafi 45; dhe
- [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, paragrafi 83.

(ii) Sjellja e palëve në procedurë

Sjellja e parashtruesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marr parasysh në konstatim, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, sipas garancive të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

- [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, paragrafi 83; dhe
- [KI67/23](#), parashtrues *Ejup Koci*, paragrafët 138-143.

Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së shembuj të sjelljes së parashtruesit të kërkesës që mund të kontribuojnë në zvarritje të procedurës mund të përbëjnë:

- Mungesa e gatishmërisë/vullnetit të palëve në paraqitjen e parashtrësive mund të kontribuojë në ngadalësimin e procedurës;
- Ndërrimi i shpeshtë i përfaqësuesit ligjor;
- Kërkesa apo mosveprime që kanë ndikim në zhvillimin e procedurës, ose mungesa e kujdesit për ndjekjen e hapave proceduralë;
- Inicimi gabimisht i një procedurë para një gjykate të cilës i mungon juridiksioni; ose
- Sjellje të dëmshme të dëshmuara nga parashtrësia të shumta dhe pretendime të tjera.

- [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, paragrafi 87.

(iii) Sjellja e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike

Gjykata ka theksuar se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe si rrjedhojë nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj tërë rendit juridik do të rrezikohet.

- [KI 64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, paragrafi 73.

Gjykata gjithashtu ka theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura.

- [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, paragrafi 96.

Gjykata po ashtu ka specifikuar se nuk është funksioni i Gjykatës që të analizojë mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin, megjithatë konsideron se aktgjykimet që anulohen të gjeturat e gjykatës së shkallës më të ulët dhe që rikthejnë çështjen në rigjykim/rivendosje janë zakonisht për shkak të gabimeve të kryera nga ato dhe se rivendosjet/rigjykimet e vazhdueshme mund të shfaqin një mangësi në sistemin e drejtësisë.

- [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, paragrafi 99.

Shkaktimi i vonësive nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve, nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme

- [KI 64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, paragrafi 72.

Gjykata ka specifikuar se çështja e zgjidhjes së rasteve nga ana e gjykatave të rregullta brenda një afati të arsyeshëm kohor kërkon një adresim dhe zgjidhje më të përshtatshme dhe emergjente nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e cila në praktikë duhet që të dëshmojë se procesi i ndërmarrë nga ky i fundit ka rezultuar në përmirësimin e mbingarkesës së gjykatave. Gjykata konsideron se çështja e zgjidhjes së rasteve nga gjykatat e rregullta brenda një afati të arsyeshëm kohor, e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, kërkon veprime dhe adresim më të përshpejtuar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata po ashtu ka vlerësuar se një reformë e tillë e nisur nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që synon përshpejtimin e shqyrtimit të lëndëve nuk do të mund të justifikonte vonesat sepse i takon këtij organi që të organizojë hyrjen në fuqi të kësaj reforme dhe zbatimin e saj në mënyrë që të mos zgjasë shqyrtimi i çështjeve ende të pazgjidhura.

- [KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 109.

(iv) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin

Gjykata, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka sqaruar se shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë, ndër të tjera, rastet që (i) ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil; (ii) rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, (iii) kontestet nga marrëdhënia e punës; (iv) rastet e parashtruesve që vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*”; dhe (v) rastet rreth të drejtës për arsim. Gjykata, në rrethanat e një rasti, duke rikujtuar faktin që ndërlidhej me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si rezultat i lëndimeve trupore të pësuar në vendin e tij të punës, për të cilat lëndime i njëjti është dashur të trajtohej jashtë vendit, vlerësoi se gjykatat e rregullta do duhej të ishin përgjigjur me kujdes të veçantë lidhur me rastin e tij.

- [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafët 103 dhe 104.

II. Rastet e Gjykatës, përmes të cilave janë vendosur parimet dhe kriteret përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

Në vijim do të pasqyrohen përmbledhjet e disa vendimeve konkrete, në të cilat Gjykata Kushtetuese, duke aplikuar parimet dhe kriteret e lartcekura të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore, ka vlerësuar dhe shqyrtuar nëse kohëzgjatja e procedurave është zhvilluar në pajtim me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Përmbledhjet e pasqyruara si në vijim janë të thjeshtëzuara dhe përmbajnë esencën e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe konstatimit të Gjykatës, dhe për këtë arsye çdo interpretim dhe analizë e tyre duhet të bërë në dritën e Aktgjykimit/ Aktvendimit të publikuar.

KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023

Parimi:

Kohëzgjatja e procedurave lidhur me padinë e parashtrueses së kërkesës para gjykatave të rregullta, të cilat as pas kalimit të periudhës prej më shumë se katërmëdhjetë (14) viteve, nuk kanë rezultuar në asnjë vendim gjyqësor, përbën shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

Faktet:

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest pronësor, përkatësisht padinë lidhur me vërtetimin e pronësisë të së cilës parashtruesja e kërkesës e kishte filluar në vitin 2008. E njëjta kishte parashtruar padi për vërtetim të pronësisë në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër katër (4) të paditurve të cilët jetonin jashtë Kosovës. Që nga viti 2008, Gjykata Komunale, përkatësisht Gjykata Themelore, nuk kishte vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës. Përgjatë katërmëdhjetë (14) viteve, gjykata e lartcekur ka mbajtur gjithsejtë shtatëmbëdhjetë (17) seanca gjyqësore, kryesisht të karakterit përgatitor, ndërsa procesi gjyqësor në vazhdimësi është shtyrë, kryesisht si rezultat i mospjesëmarrjes së të paditurve në seancat përkatëse. Megjithëse, Gjykata Themelore kishte vendosur komunikimin me të paditurit jashtë Kosovës nëpërmjet ftesave të dërguara përmes Ministrisë së Drejtësisë, në shumicën e rasteve të paditurit kanë munguar në seancat e përcaktuara nga Gjykata Komunale/Themelore, përfshirë duke mos e arsyetuar mospjesëmarrjen e tyre. Nga janari 2010 deri në janar 2016, përkatësisht një periudhe 6 (gjashtë) vjeçare, dhe nga shkurti 2018 deri në shtator 2020, përkatësisht një periudhe më shumë se 2 (dy) vjeçare, nuk ishte mbajtur asnjë seancë gjyqësore. Seanca e fundit gjyqësore lidhur me padinë e parashtrueses të kërkesës ishte mbajtur më 27 janar 2022.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata fillimisht përcaktoi që periudha që duhet të merret parasysh për vlerësimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, në rrethanat e rastit konkret, fillon nga 11 dhjetori 2008, kur parashtruesja e kërkesës ka parashtruar padinë në Gjykatën Komunale, deri më 15 mars 2023, kur parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, përkatësisht më shumë se katërmëdhjetë (14) vite procedura gjyqësore të cilat nuk kanë rezultuar në asnjë vendim gjyqësor. Më tej, në aplikimin e parimeve që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata, ndër të tjera, theksoi që në kontekst të (i) kompleksitetit të rastit, përkundër faktit që rrethanat e rastit ngërthejnë një kontest pronësor, marrë parasysh numrin e dëshmitarëve dhe provat e paraqitura, i njëjti nuk reflekton të jetë rast i kompleksitetit të lartë; (ii) sjelljes së palëve në procedurë, parashtruesja e kërkesës kishte marrë pjesë pothuajse në të gjitha seancat gjyqësore dhe u tregua aktive gjatë gjithë procedurës gjyqësore, duke mos

kontribuuar në zvarritjen e procedurës gjyqësore; dhe (iii) sjelljes së autoritetit publik, Gjykata Themelore, përkundër faktit që kishte mbajtur shtatëmbëdhjetë (17) seanca përgatitore, nuk kishte arritur të vendoste mbi meritat e padisë së parashtrueses së kërkesës, ndërsa, duke pasur parasysh që të paditurit jetonin jashtë vendit dhe nuk merrnin pjesë në seanca, nuk i kishte shfrytëzuar mundësitë ligjore për caktimin e përfaqësuesve të përkohshëm për të mundësuar vazhdimin e procedurës.

Përfundimi:

Marrë parasysh aplikimin kumulativ të kriterëve të lartcekura, Gjykata konstatoi se në rrethanat e rastit përkatës, kohëzgjatja e procedurës nuk mund të konsiderohet e arsyeshme dhe se, për pasojë, ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Në fund, marrë parasysh konstatimin e Gjykatës se kohëzgjatja e procedurave lidhur me padinë e parashtrueses së kërkesës përbën shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata urdhëroi Gjykatën Themelore në Gjakovë që ta njoftojë Gjykatën, sa më shpejt që është e mundur, por jo më larg se 6 (gjashtë) muaj, përkatësisht deri më 29 shkurt 2024, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës. Gjykata gjithashtu sqaroi që, ajo nuk e ka kompetencën e akordimit të kompensimit, por që bazuar në praktikën e saj gjyqësore, parashtruesja e kërkesës mund të shfrytëzoj mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejme të të drejtave të saj, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin përkatës, si rezultat i shkeljes së të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm siç është e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Referenca: [KI64/23](#)

KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajloviq*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022

Parimi:

Kohëzgjatja e procedurave lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës para gjykatave të rregullta për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite, përbën shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

Faktet:

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest pronësor ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Kuvendit Komunal të Prizrenit, që sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, i kishte marrë pronën dhe për këtë nuk e kishte kompensuar. Për pasojë, më 27 dhjetor 2004, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren duke kërkuar që të kompensohet për pronën në fjalë. Pas tri (3) vendimeve të Gjykatës Themelore në Prizren, me të cilat ishte aprovuar padia e parashtruesit të kërkesës dhe dy (2) vendimeve të Gjykatës së Apelit, përmes të cilave rasti i parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rivendosje, rasti i tij vazhdonte të jetë në shqyrtim të serishëm në Gjykatën e Apelit.

Pretendimet:

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kontestoi tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, me pretendimin se çështja e tij nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor, pasi që gjykatat e rregullta nuk kanë vendosur ende lidhur me padinë e tij të paraqitur në vitin 2004.

Vlerësimi i Gjykatës:

Lidhur me periudhën që duhet të merret parasysh në rastin konkret, Gjykata vlerësoi se periudha që duhet të merret parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e rastit të tij brenda një periudhe të arsyeshme, llogaritet nga data e parashtrimit së padisë, përkatësisht më 27 dhjetor 2004 e tutje, duke pasur parasysh që rasti i parashtruesit të kërkesës edhe pas më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) viteve pas paraqitjes së padisë ende është në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën e Apelit. Ndërsa, në aplikimin e kriterëve përkitazi me arsyeshmërinë e tejkëqitjes së procedurave, Gjykata fillimisht konstatoi se, (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest pronësor me tre (3) palë të ndryshme të përfshira në procedurë, nuk rezultoi të jetë i një natyre aq të ndërlikuar sa që do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e kontestit përkatës të mos përfundojë as për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejkëqitjen e procedurës përmes veprimeve të tij por vetëm ka ndjekur hapat procedural për realizimin e të drejtës së tij për kompensim lidhur me pronën e kontestuar; ndërsa (iii) gjykatat e rregullta, as pas më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite, nuk kanë zgjidhur rastin e tij, pasi i njëjti ende pret për t'u zgjidhur nga Gjykata e Apelit sipas ankesës.

Përfundimi:

Marrë parasysh aplikimin kumulativ të kriterëve të lartcekura, Gjykata konstatoi se në rrethanat e rastit përkatës, kohëzgjatja e procedurës nuk mund të konsiderohet e arsyeshme dhe se, për pasojë, konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Marrë parasysh konstatimin e Gjykatës se kohëzgjatja e procedurave lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës përbën shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata urdhëroi Gjykatën e Apelit që ta informojë sa më shpejt që është e mundur, por jo më larg se deri më 22 qershor 2023, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të saj. Gjykata gjithashtu sqaroi që, ajo nuk e ka kompetencën e akordimit të kompensimit por që, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, parashtruesi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejme të të drejtave të tij, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo-material, si rezultat i shkeljes së të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç është e garantuar me nenin 31 [Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Referenca: [KI06/21](#)

[KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022

Parimi:

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore për më shumë se katërmëdhjetë (14) vjet në një rast që nuk ka qenë i ndërlikuar, sepse gjykatat e rregullta thjeshtë kanë aplikuar dhe interpretuar dispozitat e ligjit të aplikueshëm përkitazi me afatshmërinë dhe parashkrimin e kërkesëpadisë përkatëse, kur parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejkëqitjen e procedurës përmes veprimeve të tij dhe vetëm ka ndjekur hapat proceduralë për realizimin e të drejtës së tij për kompensim të dëmit që e kishte pësuar në vendin e punës, përbën shkelje të parimit të gjykimit brenda një afatit të arsyeshëm.

Faktet:

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një padi për kompensim të dëmit, të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur kundër Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2000, pas lëndimeve trupore që kishte pësuar në vendin e punës në objektin e Shkollës Filllore “Enver Hadri”, në Smrekonicë të Vushtrrisë. Që nga padia fillestare, përkitazi me këtë rast janë zhvilluar dy procedura të ndryshme gjyqësore përgjatë njëzet viteve. Më saktësisht, padia e parë e parashtruesit të kërkesës kishte përfunduar me Aktvendimin [Rev.nr.97/2004] e 25 janarit 2005 të Gjykatës Supreme dhe përmes të cilit ishte konstatuar se padia e parashtruesit të kërkesës është e palejuar, për shkak se Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i mungon legjitimiteti pasiv procedural. Ndërsa, padia e dytë e parashtruesit të kërkesës, e paraqitur në vitin 2006, me të njëjtin objekt kontesti, por kësaj radhe kundër Shkollës Filllore “Enver Hadri”, pas tri vendimeve të Gjykatës Komunale, respektivisht Themelore, dhe tri vendimeve të Gjykatës së Apelit, përfundimisht kishte përfunduar përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të vitit 2020, sipas të cilit, ndër të tjera, padia e parashtruesit të kërkesës është shpallur e pasafatshme për shkak të afateve të parashkrimit.

Pretendimet:

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kontestoi konstatimet e Gjykatës Supreme, duke pretenduar, ndër të tjera, se: (i) gjykatat e rregullta kishin zbatuar dhe interpretuar në mënyrë arbitrare ligjin lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë së tij; dhe se (ii) çështja e tij nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, në kundërshtim me garancitë e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, vlerësoi se tejkëqatja e procedurave gjyqësore në rrethanat e rastit konkret, kishte rezultuar në shkëlqje të neneve të lartcekura. Më saktësisht, në vlerësimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës se çështja e tij nuk ishte vendosur brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata fillimisht sqaroi se, ajo nuk mund të merr parasysh periudhën kohore lidhur me padinë e parë, pasi e njëjta ishte iniciuar nga parashtruesi i kërkesës më 2 nëntor 2000 dhe procedurat rreth saj kishin përfunduar më 25 janar 2005, përkatësisht, para se të hynte në fuqi Kushtetuta, më 15 qershor 2008, dhe se ajo nuk mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e akteve juridike para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se periudha që duhet të merret parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e rastit të tij brenda një periudhe të arsyeshme kohore, llogaritet nga data e parashkrimit të padisë së dytë, përkatësisht më 18 prill 2006, e deri në vendimin e fundit lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr. 239/2019] e 26 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme. Më pas, Gjykata konstatoi se rasti konkret: (i) nuk ka qenë i ndërlidhur sepse gjykatat e rregullta thjeshtë kanë aplikuar dhe interpretuar dispozitat e ligjit të aplikueshëm përkitazi me afatshmërinë dhe parashkrimin e kërkesëpadisë përkatëse; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejkëqatjen e procedurës përmes veprimeve të tij dhe vetëm ka ndjekur hapat proceduralë për realizimin e të drejtës së tij për kompensim të dëmit që e kishte pësuar në vendin e punës; kurse (iii) gjykatave të rregullta iu janë dashur më shumë se katërmbydhjetë (14) vjet për të konstatuar me vendim të formës së prerë nëse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar ose jo.

Përfundimi:

Marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, Gjykata konstatoi se në rrethanat e rastit përkatës, kohëzgjatja e procedurës nuk mund të konsiderohet e arsyeshme

dhe se, për pasojë, ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Në fund, marrë parasysh konstatimin e Gjykatës, se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë vetëm në shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata nuk e shfuqizoi të njëjtin. Gjykata gjithashtu sqaroi që ajo nuk ka kompetencën e akordimit të kompensimit, por që bazuar në praktikën e saj gjyqësore, parashtruesi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejshëm të të drejtave të tij, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo-material, si rezultat i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Referenca: [KI19/21](#)

KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2017
Parimi:

Kohëzgjatja e procedurave para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), për gjashtë (6) vjet e nëntë (9) muaj, në një rast që ka të bëjë me të drejtën e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes ku kishin punuar parashtruesit e kërkesës, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme duke pasur parasysh se të dy shkallët përkatëse kishin kryer procedurat me “zell të arsyeshëm”.

Faktet:

Parashtruesit e kërkesës ishin ish-punëtorë të një ndërmarrje shoqërore e cila i ishte nënshtruar procesit të privatizimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Në vitin 2009, parashtruesit e kërkesës në DHPGJS kishin paraqitur ankesa për mospërfshirjen e tyre në listën e 20% të të ardhurave nga privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjes. Procedura gjyqësore e zhvilluar pranë dy kolegjeve të DHPGJS-së, kishte zgjatur gjashtë (6) vjet e nëntë (9) muaj.

Pretendimet:

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se tejzgjatja e procedurës gjyqësore para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së ka rezultuar në cenimin e të drejtës së tyre për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, në dritën e kompleksitetit të rastit, mori parasysh se (i) **dy (2) aktgjykime ishin nxjerrë në merita** dhe se rasti kishte të bënte me **98 ankues** dhe kështu përfshinte 48 ankesa, dhe se secila prej tyre kërkonte një vlerësim të individualizuar dhe të veçantë. Në vijim, Gjykata po ashtu mori në konsideratë (ii) **numrin e madh të dokumenteve** të përfshira në procedurë që të gjitha kërkonin përkthim dhe verifikim.

Përfundimi:

Rrjedhimisht, Gjykata e shpalli kërkesën e tyre të papranueshme si qartazi të pabazuar ashtu siç përcaktohet me rregullin 34(2) të Rregullores së punës së Gjykatës.

Referenca: [KI23/16](#)

KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 majit 2018

Parimi:

Duke marrë parasysh natyrën “arsyeshëm komplekse” të rastit, numrin e palëve të përfshira në procedurë, faktin që parashtruesi i kërkesës ndërroi avokatët disa herë dhe se rasti ishte shqyrtuar si nga Gjykata Themelore ashtu edhe nga Gjykata e Apelit, Gjykata konstatoi se gjykatat e rregullta i zhvilluan procedurat e tyre me “zell të arsyeshëm” dhe nuk ishin pasive në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës.

Faktet:

Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore për anulimin e një kontrate për dhuratën e disa paluajtshmërive e lidhur ndërmjet personave të tretë. Gjykata Themelore, kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Si rezultat i ankesës së tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit çështjen e kishte kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore.

Pretendimet:

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se tejzgjatja e procedurës së rivendosjes para Gjykatës Themelore kishte cenuar të drejtën e tij për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Vlerësimi i Gjykatës:

Në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në tërësinë e tyre për një kërkesë në lidhje me vërtetimin e pronësisë mbi parcelat kadastrale, që zgjati gjashtë (6) vjet e gjashtë (6) muaj, Gjykata konstatoi se duke pasur parasysh (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palëve, (iii) sjelljen e gjykatave përkatëse dhe (iv) atë që ishte në rrezik për parashtruesin e kërkesës, e gjithë kohëzgjatja e procedurës nuk mund të konsiderohej e paarsyeshme.

Përfundimi:

Rrjedhimisht, Gjykata e shpalli kërkesën e tij shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar ashtu siç përcaktohet përmes rregullit 34(2) të Rregullores së punës së Gjykatës.

Referenca: [KI18/18](#)

KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2021

Parimi:

Kohëzgjatja e dy procedurave, asaj jo-kontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë mbi pronën e kontestuar dhe asaj kontestimore për vërtetimin e pronësisë, e cila arriti në katër (4) vjet e njëmbëdhjetë (11) muaj në Gjykatën Themelore, dhe përfshirjes së palëve të treta në këto dy procedura nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme.

Faktet:

Parashtruesi i kërkesës në vitin 2015 kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore për vërtetim të kufirit (mezhdës) të paluajtshmërisë dhe vërtetim të pronësisë mbi pronën, të cilën ai e konsideronte të uzurpuar. Para Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj ishin

zhvilluar procedura jo-kontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë dhe ajo kontestimore në lidhje me vërtetimin e pronësisë.

Pretendimet:

Parashtruesi i kërkesës pretendon se tejzgjatja e procedurës para Gjykatës Themelore, e cila akoma nuk kishte arritur që të vendoste lidhur me kërkesëpadinë e tij cenonte të drejtën e tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Vlerësimi i Gjykatës:

Duke vënë në dukje se Gjykata Themelore në Mitrovicë kishte [komunikuar në mënyrë të vazhdueshme](#) me parashtruesin e kërkesës dhe e kishte njoftuar për veprimet procedurale që kishte ndërmarrë përkitazi me rastin e tij në lidhje me vërtetimin e kufirit (mezhdës) të pronës së paluajtshme, Gjykata konstatoi se Gjykata Themelore [nuk kishte qenë pasive](#) në trajtimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës.

Përfundimi:

Rrjedhimisht, Gjykata e shpalli kërkesën e tij të papranueshme si qartazi të pabazuar ashtu siç përcaktohet përmes rregullit 34(2) të Rregullores së punës së Gjykatës.

Referenca: [KI104/20](#)

[KI183/21](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2021

Parimi:

Veprimet e njëpasnjëshme procedurale të ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës mund të kenë ndikuar në vonesën e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në Degën në Skenderaj dhe në Degën në Vushtrri, respektivisht, në shqyrtimin e rastit të tij në merita.

Faktet:

Faktet e rastit janë të njëjta si ato në rastin KI104/20, përkatësisht i referohen procedurës kontestimore dhe asaj jo-kontestimore të zhvilluara në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj. Përderisa procedura në lidhje me rastin e tij ishte duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore, Dega në Skenderaj, më 8 tetor 2020, Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë kishte aprovuar kërkesën e gjyqtarit të lëndës së që të përjashtoj nga ky rast. Si rezultat, lënda e parashtruesit të kërkesës i ishte ricaktuar një gjyqtari tjetër për vendosje në Gjykatën Themelore në Mitrovicë por Dega në Vushtrri.

Pretendimet:

Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij të radhës të parashtruar në Gjykatë sërish pretendoi se Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, si dhe Dega në Vushtrri kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm pasi rasti i tij nuk ishte zgjidhur as pas më tepër se katër (4) vitesh të shqyrtimit nga Gjykata Themelore.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, në kontekst të përcaktimit të periudhës kohore që duhet të merrej parasysh përkitazi me kërkesën e tanishme morri për bazë edhe konstatimin e saj përmes Aktvendimit të saj për Papranueshmëri në rastin KI104/20 dhe vendosi që të merrej parasysh procedura

kontestimore, e rifilluar në vitin 2018 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj nga data e regjistrimit të lëndës së parashtruesit të kërkesës me numër rendor [C.nr. 256/2018], si dhe procedurën e zhvilluar në degën e kësaj gjykate në Vushtrri deri në parashtrimin e kërkesës së tanishme në Gjykatë.

Në këtë rast, Gjykata, në kuptim të vlerësimit të faktorëve për të vlerësuar nëse kohëzgjatja ishte e arsyeshme, në mënyrë specifike, vuri në pah se si rezultat i veprimeve të tij lënda ishte transferuar në një degë tjetër të Gjykatës Themelore, dhe vlerësoi se sjellja e parashtruesit të kërkesës kishte ndikuar në zvarritje të procedurave.

Përfundimi

Rrjedhimisht, Gjykata kërkesën e tij e shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar ashtu siç përcaktohet përmes rregullit 34(2) të Rregullores së punës së Gjykatës.

Referenca: [KI183/21](#)

Lista e rasteve

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Aktgjykimet

[Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë](#), nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019
[Mishgjoni kundër Shqipërisë](#), nr. 18381/05, Aktgjykim, i 7 dhjetorit 2010
[Sürmeli kundër Gjermanisë](#), nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006
[Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006
[Scordino kundër Italisë](#), (nr.1), [DhM] nr.36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006
[Mikulić kundër Kroacisë](#), nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002
[Frydlender kundër Francës](#), nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000
[Comingersoll S.A. kundër Portugalisë](#), nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000
[Abdoella kundër Holandës](#), nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992
[Poiss kundër Austrisë](#), nr. 9816/82, Aktgjykim, i 23 prillit 1987
[Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), nr. 9616/81, Aktgjykim, i 23 prillit 1987

Gjykata Kushtetuese

Aktgjykimet

[**KI 64/23**](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023
[**KI 06/21**](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022
[**KI 19/21**](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022
[**KI117/19**](#), parashtrues *NNT “Sokoli”*, Aktgjykim i 29 marsit 2021

Aktvendimet për papranueshmëri

[**KI67/23**](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 korrikut 2024
[**KI152/23**](#), parashtrues *Burim Zherka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 qershorit 2024
[**KI202/22**](#), parashtrues *NP “Elektroprivreda Srbije”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2024
[**KI02/22**](#), parashtrues *“Elektrosever” sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2023
[**KI03/22**](#), parashtrues *“EPS TREGOVINA”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 shtatorit 2022
[**KI183/21**](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 marsit 2022
[**KI135/20**](#), parashtruese *Hava Behxheti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 dhjetorit 2020
[**KI104/20**](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2021
[**KI13/19**](#), parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2019
[**KI110/18**](#), parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2018
[**KI18/18**](#), parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 majit 2018
[**KI109/17**](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 majit 2018
[**KI19/17**](#), parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 shkurtit 2018
[**KI94/17**](#), parashtrues *Muhamedali Ceyşülmedin*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 shkurtit 2018
[**KI127/15**](#), parashtrues *Mile Vasović*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 qershorit 2017
[**KI23/16**](#), parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 marsit 2017